



A.nr.527/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi- Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi, anëtare me Ilire Mehmeti-Shaqiri, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.527/2026 të datës 13.05.2026, të parashtruar nga ankuesi S.P, kundër organit të punësimit: Zyra e Kryeministrit në çështjen juridike ‘*kontestim konkursi*’, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1; nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 08.07.2026, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e parakohshme ankesa me numër A.nr.527/2026 e datës 13.05.2026, e parashtruar nga ankuesi S.P.

A r s y e t i m

Ankuesi S.P (me tej referuar vetëm ankuese), më datë 13.05.2026, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar nën shenjë A.nr. 527/2026, me pretendimet ankimore lidhur me konkursin RN00019469, të datës 18.03.2026, për, për pozitën ‘ Drejtor i Zyrës për Çështje të Komuniteteve, të zhvilluar nga Ministria e Digjitalizimit dhe Administratës Publike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 28.05.2026 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën tek Ministria e Digjitalizimit dhe Administratës Publike , ndërsa kjo e fundit, më datë 29.05.2026, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave administroi këto prova: Ankesën A.nr.527/2026 të datës 13.05.2026 drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi me Nr.60/2026 i datës 30.04.2026 për refuzimin e aplikacionit; Përgjigje e datës 30.01.2024 nga MASHT-i; Kopja e ID kartelës; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 28.05.2026; Përgjigje në ankesë e datës 29.05.2026.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar provat materiale të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi së ankesa e ankuesit është e palejuar, sepse:

Nga administrimi i provave të lëndës rezulton se Ministria e Digjitalizimit dhe Administratës Publike me datë 18.03.2026, ka shpallur konkursin me numër reference RN00019469 për pozitën e punës “Drejtor i Zyrës për Çështje të Komuniteteve.

Ankuesi me datë 13.05.2026 parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil duke kundër Vendimi me Nr.60/2026 i datës 30.04.2026 për refuzimin e aplikacionit; shtuar ligjshmërinë e procedurës së rekrutimit, respektivisht pretendon se aplikacioni në fazën e verifikimit paraprak i është refuzuar pa bazë ligjore.

Në kuptim të pranueshmerisë së ankesës Kolegji i Këshillit i'u referua dispozitave të nenit 39 paragrafi 12 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, me të cilin është përcaktuar se:...12. *Kandidatët/ët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK sipas afatit të përcaktuar në ligjin përkatës për procedurën administrative.. si dhe nenit 17 të Rregullores (QRK) Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimi në Shërbimin Civil, me të cilin shprehimisht parashihet se: Ankesa në procedurë pranimit. 1. *Kandidatët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK në afat prej tridhjetë (30) ditëve dhe rrjedhimisht konstatoi se kandidati për pranim në Shërbim Civil, në rast të pakënaqësive me procesin e rekrutimit ka të drejtë të parashtoj ankesë vetëm pas shpalljes së rezultateve përfundimtare, ndërsa, në rastin konkret ankesa është parashtruar me datë 13.05.2026 në ditën në të cilën është bërë njoftimi për refuzimin të aplikacionit dhe si rrjedhojë nga shkresat e lëndës konstatohet se procedura e rekrutimit sipas konkursit me referencë RN00019469 për pozitën “Drejtor i Zyrës për Çështje të Komuniteteve, është përfunduar faza e verifikimit paraprak të aplikacioneve të kandidatëve, dhe se procedura është në proces, andaj mbi bazën e kësaj rezulton së ankesa e ankuesit është e parakohshme, dhe si e tillë është e palejueshëm në kuptim të dispozitave të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.**

Theksuar si me sipër, e në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L 048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitivin e këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur, e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë/Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
LËNDA: A.nr 527/2026

Ilire Mehmeti-Shaqiri

Eshref Shabani

Procesmbajtës

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit, S.P;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Digjitalizimit dhe Administratë Publike, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së